

C.nr.428/2009

**GJYKATA THEMELORE NË Ferizaj -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Burim Emërllahu, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditëses [REDACTED] nga Ferizaji, ndërhyrësve kryesorë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], të gjithë nga [REDACTED], Komuna e Ferizajit, të cilët me autorizim i përfaqëson avokati [REDACTED] nga Ferizaji, kundër të paditurëve [REDACTED], [REDACTED], nga Ferizaji, tani me adresë të panjohur të vendbanimit, të cilët në cilësin e përfaqësueses së përkohshme i përfaqëson avokatja [REDACTED] nga Ferizaji, baza juridike vërtetimi i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë me datë 16.06.2017, mori këtë:

### AKT GJYKIM

**APROVOHET SI BAZUAR** kërkesëpadia paditëses [REDACTED] dhe e ndërhyrësve kryesorë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED].

**I.** Vërtetohet se paditësja [REDACTED] është pronare e sipërfaqës prej 2119 metra katëror, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 42-5, Zona Kadastrale në Ferizaj dhe sipërfaqja e sipër përmendur prej 2119 m<sup>2</sup> ka këto kufi dhe përmasa: nga ana lindore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-6, në gjatësi prej pikës 1 deri pikën 2,89.74 metra, në anën jugore kufizohet me ngastrën kadastrale 43-1 në gjatësi prej pikës 2 deri 3, 24.04 metra, në anën përendimore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5, në gjatësi prej pikës 3 deri 5, 17.30 metra, prej pikës 5 deri në pikës 6, 42.26 metra, prej pikës 6 deri në pikën 7, 24.79 metra, dhe në anën veriore me rrugën kryesore Ferizaj - [REDACTED], prej pikës 7 deri 1, në gjatësi prej 26.09 cm.

**II.** Vërtetohet se ndërhyrësi kryesorë [REDACTED] është pronarë i sipërfaqes prej 304 metra katëror, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 42-5, Zona Kadastrale në Ferizaj dhe sipërfaqja e sipër përmendur prej 304 m<sup>2</sup> ka këto kufi dhe përmasa: në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 ZK Ferizaj, prej pikës 1 deri 2, është 17.20 m., në anën veriore kufizohet me ngastrës kadastrale 42-5, prej pikës 2 deri 3, 17.44 metra, në anën përendimore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 prej pikës 3 deri pikën 4, në gjatësi prej 17. metra e 60 cm., në anën jugore kufizohet me ngastrën kadastrale 43-1 prej 4 deri te pika 1 në gjatësi prej 17. metra e 18 cm.

**III.** Vërtetohet se paditësi [REDACTED] është pronarë i ngastrës kadastrale nr.42-6, Zona Kadastrale në Ferizaj.

**IV.** Vërtetohet se ndërhyrësit kryesorë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] janë bashkëpronarë, në nga 1/5 pjesë ideale të sipërfaqeve në

vijim: sipërfaqës prej 542 metra katëtor e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 42-5 Zona Kadastrale Ferizaj dhe sipërfaqes prej 1611 m<sup>2</sup>, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale nr. 42-5 Zona Kadastrale Ferizaj. Sipërfaqja e sipër përmendur prej 542 m<sup>2</sup> ka këto kufi dhe përmasa: ka lindja kufizohet me pjesën e ngastrën kadastrale 42-5 Zk Ferizaj, me dimensione prej pikës 1 deri në pikën 2, gjatësia 29.83 metra, nga ana jugore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 ZK Ferizaj, nga pika 2 deri në pikën 3, 9.40 metra, nga pika 3 dhe 4, 9.55 metra, nga ana përendimore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 në gjatësi prej 4 deri 5, 11.93 metra, prej pikës 5 deri pikën 6, 8.94 metra, dhe prej pikës 6 deri 7 te rruga 6.60 metra. në anën veriore kufizohet me rrugën publike prej pikës 7 deri në pikën 1, 19.71 metra. Sipërfaqja e sipër përmendur prej 1611 metra katëror, ka këto kufi dhe përmasa: Në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5, në gjatësi prej pikës 17 deri 16, 48.95 metra, prej pikës 16 deri 15, me gjatësi prej 31.30 metra, në anën jugore kufizohet me ngastrën kadastrale 43-1, prej pikës 15 deri 14 është 28.86 metra, në anën përendimore kufizohet me ngastrat kadastrale 42-8, 42-9 dhe 42-10 ZK Ferizaj në anën veriore kufizohet me rrugë kryesore Ferizaj – [REDAKTUAR], dhe ate prej pikës 8 deri 7, në gjatësi prej 4.89 metra, prej pikës 7 deri pikë 6, 6.60 metra, prej pikës 6 deri pikën 5, 8.94 metra, prej pikës 5 deri 4, 11.93 metra, prej pikës 4 deri 3, 9.55 metra, prej pikës 3 deri 2 9.40 metra, prej pikës 2 deri 1 29.83 metra.

V. Vërtetohet se ndërhyrësi kryesorë [REDAKTUAR] është bashkëpronare në ½ pjesë ideale të sipërfaqes prej 334 m<sup>2</sup>, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 42-5 Zona kadastrale në Ferizaj, dhe sipërfaqja e sipër përmendur prej 334 m<sup>2</sup> ka këto kufi dhe përmasa në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 ZK Ferizaj, në gjatësi prej pikës 3 deri 5, 17.30 metra, prej pikës 5 deri 6 në gjatësi 42.26 metra, prej pikës 6 deri 7, 24.79 metra, në anën veriore kufizohet me rrugën kryesore prej pikës 7 deri 8, në gjatësi prej 4 metra, , në anën përendimore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 prej pikës 8 deri 9, 24.32 metra, prej pikës 9 deri 10, 42.16 metra, dhe prej pikës 10 deri 11, 17.20 metra, në anën jugore kufizohet me ngastrës kadastrale 43-1, prej pikës 11 deri 3,4 metra.

Vërtetohet se paditësja [REDAKTUAR] është bashkëpronare në ½ pjesë ideale të sipërfaqes prej së sipër përmendur prej 334 m<sup>2</sup>, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 42-5 zona kadastrale në Ferizaj, e cila ka këto kufi dhe përmasa në anën lindore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 ZK Ferizaj, në gjatësi prej pikës 3 deri 5, 17.30 metra, prej pikës 5 deri 6 në gjatësi 42.26 metra, prej pikës 6 deri 7, 24.79 metra, në anën veriore kufizohet me rrugën kryesore prej pikës 7 deri 8, në gjatësi prej 4 metra, , në anën përendimore kufizohet me ngastrën kadastrale 42-5 prej pikës 8 deri 9, 24.32 metra, prej pikës 9 deri 10, 42.16 metra, dhe prej pikës 10 deri 11, 17.20 metra, në anën jugore kufizohet me ngastrës kadastrale 43-1, prej pikës 11 deri 3, 4 metra.

VI. Detyrohen : paditësja [REDACTED], nga Ferizaji, ndërhyrësit kryesorë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], nga Ferizaji që kësaj gjykate në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi t'ia paguajnë shumën e të hollave prej 55 euro.

### A r s y e t i m

**Pika I.** Paditësi [REDACTED] ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], të gjithë nga Ferizaji, tani me adresë të pa njohur të vendbanimit, me bazë juridike vërtetimi i së drejtës së pronësisë.

Pas parashtrimit të padisë nga paditësi [REDACTED], në këtë procedurë kanë ndërhyrë në cilësinë e ndërhyrësve kryesor [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], kurse nga provat e administruara rezulton se ndërhyrësit kryesorë kanë interes juridik për të ndërhyrë në këtë procedurë.

Meqë gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore në lidhje me këtë çështje civilo-juridike me datën 18.09.2016 ka vdekur paditësi [REDACTED], procedurën në vend të tij e ka marrë për sipër bashkëshortja e tij trashëgimtarja [REDACTED] e cila është shpallur trashëgimtare me aktvendimin LRP .nr.1586/2017 të dt. 21.04.2017, i nxjerrur nga noteri [REDACTED], nga Ferizaji.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses [REDACTED] dhe ndërhyrësve kryesor avokati [REDACTED] nga Ferizaji ka kërkuar nga gjykata që ta aprovtoj si të bazuar kërkesë padinë e paditëses [REDACTED], dhe ndërhyrësve kryesor me përmbajtje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Përfaqësuesja e përkohshme e të paditurve av. [REDACTED] ka theksuar me 24 nëntor 2014 jam caktuar përfaqësuese e përkohshme e të paditurëve, pronar juridik i paluajtshmërive, konform dispozitive ligjore brenda afatit ligjor kam dorëzuar përgjigje në padi në këtë gjykatë, pas materialeve të ofruara, ekspertizës së ekspertit gjeodet, daljes në teren, ekspertizë kjo e cila në tërësi përputhet me gjendjen faktike të pasurisë së paluajtshme, objekt kontesti, e po ashtu edhe pas dëgjimit të dëshmitarve si dhe paditësve në cilësinë të dëshmitarve vërtetohet bazueshmëria ligjore e kësaj padie të parashtruar në këtë gjykatë prandaj i propozoj gjykatës që të marrë vendim meritore konform dispozitive në fuqi.

**Pika II.** Me qëllim të vlerësimit sa më të drejtë dhe të plot të gjendjes faktike në këtë çështje civilo juridike gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar si provë: skica e dt. 06.03.2017, skica e dt. 08.08.2014, skica e dt. 08.05.2014, skica e dt. 10.04.2014, shikimi në 12 foto, historiat, për paluajtshmërinë kontestuese i dt. 23.03.2017, së bashku me dokumente përcjellëse, aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit [REDACTED]

██████████ certifikata e dt. 25.04.2017, njoftimi i dt. 20.02.2017, aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit ██████████, i dt. 03.06.2008, certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, e dt. 04.05.2015, kërkimi i thjesht për njësinë kadastrale, shikimi në një kopje të planit të dt. 11.11.1975, leximi i certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, e dt. 15.09.2009 si dhe janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve ██████████ ██████████ ██████████ ██████████ ██████████, si dhe janë dëgjuar në cilësi në cilësi të palëve ndërhyrësit kryesorë ██████████ ██████████ ██████████ ██████████ ██████████, si dhe paditësja ██████████.

**Pika III.** Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe pas vlerësimit të provave të administruara ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit gjeodet ██████████, kërkimi i thjesht për njësinë kadastrale si dhe shkresa- historiat për paluejtshmërin kontestuese i dt. 23.03.2017, i lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj gjykata ka vërtetuar, se paluajtshmëria kontestuese e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi në Zyrën Kadastrale Komunale në Ferizaj, evidentohet si bashkëpronësi në emër të ██████████ ██████████.

Nga mendimi dhe konstastimi i ekspertit gjeodet ██████████ gjykata ka konstatuar se paluajtshmëria kontestuese ka kufi dhe përmasat ashtu siq është cekur në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata ka bërë përpjekje që siguroj adresat e vendbanimit për të paditurit ██████████ ██████████, ██████████, ██████████, për çka edhe ju ka drejtuar me këkresën e datës 15.02.2017 Zyrës së Regjistrimit Civil në Ferizaj, mirëpo Zyra e Gjendjes Civile me shkresën e datës 20.02.2017 ka theksuar, gjegjësisht e ka njoftuar gjykatën se ██████████ ██████████, dhe ██████████ nuk janë regjistruar në regjistrin digjital lindjes dhe nuk ka mundësi ti siguroj adresat e banimit për të njejt.

Me leximin e aktvendimit T.nr.231/07 I dt. 03.07.2008, gjykata ka vërtetuar se trashëgimtar i të ndjerit ██████████ është shpallur djali i tij tani ndërhyrësi kryesor ██████████.

Me leximin e aktvendimit numër LRP nr.1586/2017 I dt. 21.04.2017 gjykata ka vërtetuar se trashëgimtare e të ndjerit ██████████, është shpallur bashkëshortja e tij ██████████.

Me dëgjimin e dëshmitarit ██████████ gjykata ka vërtetuar se ██████████ ██████████ para më shumë se 40 viteve, e ka blerë paluejtshmërin kontestuese të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga të paditurit ██████████ ██████████ ██████████ dhe të njejtëve ua kishte paguar në tërësi qmimin e shitblerjes së të njejtës paluejtshmëri.

kurse të paditurit [REDACTED], [REDACTED] ka kishin dorëzuar paluejtshmërinë në fjalë në posedim,

Me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] gjykata ka vërtetuar se diku për afërsisht në vitin 1980 [REDACTED] dhe [REDACTED] ndërhyrësve [REDACTED], [REDACTED], dhe [REDACTED] ua kanë shitur paluajtshmërinë e cekur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kurse ndërhyrësit [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], ia kanë paguar [REDACTED] [REDACTED] në tërësi çmimin e shitblerjes të asaj toke, kurse [REDACTED] ndërhyrësve [REDACTED], ua kanë dorëzuar në posedim paluajtshmërinë e cekur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, të cilën [REDACTED] e posedojnë më shumë se 30 vite, pa u penguar nga askush dhe pasi ndërhyrësit kryesor [REDACTED], [REDACTED] kanë blerë paluajtshmërinë në fjalë kanë filluar ndërtimin e shtëpive të tyre në tokën e blerë. Kurse faktin se ndërhyrësit [REDACTED] paluajtshmërinë kontestuese e kanë blerë nga M [REDACTED] dhe të njëjtëve u kanë paguar në tërësi çmimin e shitblerjes, gjykata e ka vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] M [REDACTED]

Gjykata poashtu, edhe me dëgjimin e dëshmitarëve, [REDACTED], [REDACTED] ka vërtetuar se ndërhyrësit [REDACTED] dhe [REDACTED] paluajtshmërinë e cekur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi e kanë në posedim pa u penguar nga askush më tepër se 30 vite, në atë mënyrë që në atë paluajtshme kanë ndërtuar shtëpi ku edhe jetojnë, kurse një pjesë të asaj paluajtshme e shfrytëzojnë si oborr, ndërsa [REDACTED], në një pjesë të asaj paluajtshme e ka të ndërtuar edhe një lokal. Oborret e se cilit prej ndërhyrësve janë të ndara nga njëri tjetri me kufi faktik. Nga deklarat e dëshmitarit [REDACTED] gjykata ka vërtetuar se ndërhyrësit [REDACTED] në paluajtshme kontestuese të cekur si në pikën IV kanë ndërtuar shtëpi dhe të njëjtët nuk kanë pasur probleme me askënd për atë tokë. Nga deklarata e ndërhyrësit kryesorë [REDACTED] në cilësi të palës gjykata ka vërtetuar se [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] paluajtshme e cekur si në pikën IV e shfrytëzojnë pa u penguar nga askush më tepër se 25 vite.

Me dëgjimin e ndërhyrësve kryesorë në cilësi të palës [REDACTED], [REDACTED] në cilësi të palëve gjykata ka vërtetuar se ndërhyrësit [REDACTED] paluajtshme kontestuese të cekur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi e kanë blerë nga [REDACTED], të cilëve ua kanë paguar në të tërësi çmimin e shitblerjes së të njëjtës paluajtshme, kurse [REDACTED] të njëjtëve ua kanë

dorëzuar në posedim paluejtshmërinë në fjalë, kurse ndërhyrësit [REDACTED], [REDACTED] janë në posedim të paluejtshmërisë së cekur si në pikën IV më tepër se 30 vite, ndërsa një pjesë të sajë i'a kanë falur kunatës së tyre tani ndërhyrëses [REDACTED], në të cilën e njëjta ka të ndërtuar shtëpi. Kurse gjykata me dëgjimin e ndërhyrësës [REDACTED] në cilësi të palës dhe paditësit [REDACTED] ka vërtetuar se [REDACTED] në shtëpinë në fjalë e cila gjindet në paluejtshmërinë kontestuese jeton më tepër se 25 vite.

Gjykata poashtu me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED], ka vërtetuar se paluejtshmërinë e cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ndjeri [REDACTED], diku në vitin 1981-1982 ia ka shitur babait të ndërhyrësit [REDACTED] [REDACTED], i cili ia ka paguar [REDACTED] në tërësi çmimin e shitblerjes të asaj toke, kurse [REDACTED], [REDACTED] ia ka dorëzuar në posedim paluejtshmërinë në fjalë. [REDACTED], para se të ia shetë tokën në fjalë [REDACTED], e ka shfrytëzuar atë tokë në atë mënyrë që ka bërë kultivimin e prodhimeve bujqësore. Në momentin kur [REDACTED] ia ka shitur [REDACTED] tokën në fjalë [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë dalur te toka kontestuese dhe ia kanë caktuar edhe kufijët e asaj toke duke i vendosur megjë të gurë dhe në momentin kur janë vendosur kufijët e asaj toke me gurë [REDACTED] i ka thënë [REDACTED], “kjo është toka jote, që ta kam shitur dhe mund ta shfrytëzosh”. Pas bërjes së tokës së sipër përmendur [REDACTED], tokën në fjalë e kishte mbjellur me bari dhe në të njëjtën kishte hapur bunar-puse. Pas vdekjes së [REDACTED] tokën kontestuese e ka në posedim djali i tij [REDACTED] pa u penguar nga askush më tepër se 25 vite.

Me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED], gjykata ka vërtetuar se diku në vitin 1981 apo në vitin 1982 [REDACTED], e ka blerë paluejtshmërinë e cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi nga [REDACTED], të cilit ia ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes së asaj toke. Babai i ndërhyrësit [REDACTED] e ka poseduar atë tokë që nga blerja e derisa ka vdekur, kurse djali i tij [REDACTED] tani ndërhyrës është posedim të tokës në fjalë më tepër se 25 vite. Nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED], po ashtu vërtetohet se [REDACTED], tokën e ka shfrytëzuar si livadh, kurse babai i tij [REDACTED] [REDACTED], në atë tokë kishte hapur edhe një bunar – pus, me qëllim që ta ujit atë tokë.

Nga deklarata e dëshmitarit [REDACTED] vërtetohet se [REDACTED], tokën kontestuese e ka në posedim më tepër se 25 vite, pa u penguar nga askush.

Gjykata me dëgjimin e ndërhyrësit kryesor [REDACTED], në cilësi të palës ka vërtetuar se edhe i njëjti tokën kontestuese e ka në posedim më tepër se 20 vite, ashtu që para luftës e ka shfrytëzuar për të kullotur lopët dhe ka marrë bari për ushqim për bagëti nga e njëjta, kurse pas luftës e ka shfrytëzuar si livadh atë tokë. Por meqë fqinjët e tij,

ishin ankuar se uji nga ajo tokë po ju shkon në oborret e tyre ndërhyrësi ishte detyruar që me qëllim që të ngrit nivelin e asaj toke, të qesë gurë, zhavor të cilët i përngjajnë materialit ndërtimeor.

Me dëgjimin e ndërhyrësit [REDAKTUAR] në cilësi të palës gjykata ka vërtetuar se [REDAKTUAR], baba i [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], baba i [REDAKTUAR] e ka blerë paluajtshmërinë e cekur si në pikën III dhe e ka paguar në tersi çmimin e shitblerjes kurse [REDAKTUAR], paluajtshmërinë e cekur si në pikën III e ka në posedim për më tepër se 20 vite pa u penguar nga askush.

Gjykata poashtu me dëgjimin e ndërhyrësve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], ka vërtetuar se [REDAKTUAR], e ka blerë tokën e cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi nga [REDAKTUAR] të cilën e ka shfrytëzuar si livadh sa ka qenë në jetë [REDAKTUAR], kurse [REDAKTUAR] e ka në posedim atë tokë më tepër se 20 vite pa u penguar nga askush.

Poashtu, edhe nga deklarata e ndërhyrësit [REDAKTUAR] vërtohet se [REDAKTUAR], paluajtshmërinë e cekur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka në posedim më tepër se 20 vite, pa u penguar nga askush.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR], ka vërtetuar se paluajtshmërinë për të cilën [REDAKTUAR] ka bërë padi e ka blerë diku në vitin 1980 nga [REDAKTUAR], të cilit ia ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes së asaj toke, kurse [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] ia ka dorëzuar në posedim paluajtshmërinë e shitur, ndërsa [REDAKTUAR] në paluajtshmërinë e blerë ka ndërtimeor edhe shtëpi, ndërsa një pjesë të asaj e shfrytëzon si oborr kurse një pjesë të vogël të saj e shfrytëzon si rrugë. [REDAKTUAR], paluajtshmërinë për të cilën ka bërë padi ka shfrytëzon pa u penguar nga askush më tepër se 30 vite. Pjesën e paluajtshmërisë kontestuese të cilën [REDAKTUAR] e shfrytëzon si rrugë, i njejtë e shfrytëzon së bashku me trashëgimtarët e [REDAKTUAR], kurse sa ka qenë në jetë [REDAKTUAR] e ka shfrytëzuar së bashku [REDAKTUAR]. Faktin se paluajtshmëria e cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi iu ka shitur [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR], gjykata ka vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR].

Gjykata me dëgjimin e [REDAKTUAR], në cilësinë e palës ka vërtetuar se [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] e ka blerë tokën e cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, të cilën e shfrytëzon pa u penguar nga askush më tepër se 30 vite.

Gjykata poashtu me dëgjimin e ndërhyrësit [REDAKTUAR] në cilësinë, e palës ka vërtetuar se paluajtshmërinë e cekur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka shfrytëzuar [REDAKTUAR] sa ka qenë gjallë me ndërhyrësin [REDAKTUAR] më tepër se 20 vite, pa u penguar nga askush.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] ka vërtetuar se paditësi [REDACTED], paluajtshmërinë e cekur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka në posedim pa u penguar nga askush nga viti 1985 e deri tani.

Gjykata me dëgjimin e ndërhyrësve kryesorë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], ka vërtetuar se ndërhyrësi [REDACTED], e ka blerë paluajtshmërinë e cekur si në pikën II nga [REDACTED], dhe të njëjtën [REDACTED] e ka shfrytëzuar pa u penguar nga askush, kurse [REDACTED] dhe [REDACTED] paluajtshmërinë e cekur si në pikën V, të dispozitivit të këtij aktgjykimi e shfrytëzojnë së bashku pa u penguar nga askush me tepër se 20 vite.

Me dëgjimin e ndërhyrësit [REDACTED] në cilësinë e palës, gjykata ka vërtetuar se i njëjti tokën kontestuese për të cilën ka bërë padi e ka blerë nga [REDACTED] dhe të njëjtit ia ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes së paluajtshmërisë kontestuese, kurse [REDACTED] është në posedim të paluajtshmërisë në fjalë, pa u penguar nga askush nga viti me tepër se 30 vite.

Po ashtu me dëgjimin e ndërhyrësit [REDACTED] në cilësi të palës ka vërtetuar se [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë krijuar rrugën e përbashkët ashtu që e njëjta rrugë është krijuar në atë mënyrë që dy metra tokë i ka lëshuar [REDACTED], kurse dy metra tokë i ka lëshuar [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe [REDACTED] rrugën në fjalë, gjegjësisht paluajtshmërinë e cekur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi e kanë shfrytëzuar pa u penguar nga askush më tepër se 25 vite.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED] ka vërtetuar, se [REDACTED], paluajtshmërinë e cekur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka shfrytëzuar nga askush me tepër se 40 vite, kurse  $\frac{1}{2}$  e paluajtshmërisë së cekur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi e shfrytëzon së bashku me [REDACTED], ashtu që e njëjta paluajtshmëri gjegjësisht rrugë është krijuar në atë mënyrë, ashtu që [REDACTED] nga toka e tij e blerë i ka lëshuar dy metra për rrugë, të cilat i shfrytëzon më tepër se 20 vite, kurse [REDACTED], i ka lëshuar dy metra rrugë nga sipërfaqja e blerë të cilat i shfrytëzon më tepër se 40 vite. Paluajtshmërinë e cekur si në pikën V, të dispozitivit të këtij aktgjykimi [REDACTED] e ka shfrytëzuar më tepër se 40 vite kurse me [REDACTED] janë marrë vesh që  $\frac{1}{2}$  e asaj paluajtshmërie të i takon [REDACTED].

Gjykata poashtu, me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED], ka vërtetuar se [REDACTED], paluajtshmërinë kontestuese e ka blerë para më shumë se 40 viteve, dhe shitësve paluajtshmërinë kontestuese ua ka paguar në tersi çmimin e shitblerjes, kurse [REDACTED], e ka shfrytëzuar paluajtshmërinë pa u penguar nga askush, kurse më vonë një pjesë e të njëjtës e ka shitur.



Me dëgjimin e paditëses [REDACTED], gjykata ka vërtetuar qysh në vitin 1967 kur është martuar e njëjta me [REDACTED] [REDACTED] i ka pasur ato toka, i ka punuar ashtu që ka kultivuar produkte bujqësore dhe të njëjtin askush nuk e ka penguar që ti shfrytëzoj ato toka. Paluajtshmërinë e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi [REDACTED], e ka shfrytëzuar pa u penguar nga askush më tepër se 40 vite, ashtu që ka kultivuar produkte bujqësore. Kurse paditësja [REDACTED] te toka e ka dërguar bukën.

Gjykata poashtu me dëgjimin e ndërhyrësit [REDACTED] në cilësinë e palës, ka vërtetuar se [REDACTED] paluajtshmërinë, e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka poseduar pa u penguar nga askush me tepër se 30 vite.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED], ka vërtetuar se [REDACTED] [REDACTED] paluajtshmërinë e cekur nën pikën I si në dispozitivin e këtij aktgjykimi e ka në posedim më tepër se 30 vite pa u penguar nga askush.

Gjykata poashtu me dëgjimin e ndërhyrësve kryesor [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] ka vërtetuar se [REDACTED], tokën kontestuese e ka blerë nga [REDACTED] [REDACTED], të cilëve u ka paguar në tersi çmimin e shitblerjes e tokave në fjalë.

Gjykata poashtu me dëgjimin e ndërhyrësit [REDACTED] në cilësinë e palës ka vërtetuar se [REDACTED], tokën kontestuese të cekur si në pikën I e ka poseduar më tepër se 20 vite.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar me provat e administruara të shpjeguar si në arsyetimin e këtij aktgjykimi, e parase gjithash gjendjen faktike të shpjeguar në pikën III të arsyetimit të këtij aktgjykimi ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrur për bazë edhe dispoziten e neni 28 të Ligjit për Mardhëniet Themelore Pronësore juridike, si dhe nenin 40 të Ligjit Për Pronësin dhe të Drejtat Tjera Sendore, kuptohet për periudhën kohore në të cilën është në fuqi ky ligj.

Vendimi për shtesën e taksës gjyqësore për padi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Me datë 16.06.2017

Gjyqtari,  
Burim Emërllahu



**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.



